



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor

Nr: 04-351/02-104569

Dt. 02.09.2024

Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e Së **Sedat Asllani** me banim në fshatin Reçan ,KK Prizren, në bazë të nenit 3alineja 1 pikat 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.7, 1.16, 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 3 paragrafi 1 pika 1.6, 1.24 , 1.25 si dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe komfor nenit 33 paragrafi 1 pika 19 të Rregullores për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.001/001-46063 dt. 28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014,dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale Komunale(HZK)për periudhën 2022-2030-nr.001-011-48192 dt. 31.03.2022 e lidhur me nenin 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 27,44,46,47,48 si dhe nenit 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	<u>Sedat Asllani</u>		
Adresa:	në hyrje të fshatit Prizren-Reçan		
Telefoni:	/	Emaili:	

Emri i projektit	Ndërtim i objektit –afarist(administratë)		
Emri i projektuesit	“ Pika Design“ SH.P.K. -Prizren		
Adresa:	“ /” - Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Me këtë Vendim , aplikuesit për leje ndërtimore Sedat Asllani me banim në fshatin Reçan në Prizren i lejohe ndërtimi i objektit- afarist(administratë) **në hyrje të fshatit Prizren-Reçan,ana e majtë** në ngastrën kadastrale **P-71813070-01281-1**; Zona Kadastrale Reçan

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	ZK Reçan -KK Prizren	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Z.K.Reçan Objekti –afarist (administratë) me etazhitet 2B+P+3 do të ndërtohet në parcelën kadastrale nr. P-71813070-01281-1 -ZK Reçan me sipërfaqe S=1165 m² Sip. bruto e bodrumit -2B është S=737.3m². Sip. neto e bodrumit -2B është S=613.2m². Sip. bruto e bodrumit -1B është S=737.3m². Sip. neto e bodrumit -1B është S=613.2m². Sipërfaqe bruto e përdhese është S=425.3m². Sipërfaqe neto e përdhese është S=421.5m². Sipërfaqe bruto e katit I është S=496.3m². Sipërfaqe neto e katit I është S=445.7m². Sipërfaqe bruto e katit II është S=496.3m². Sipërfaqe neto e katit II është S=445.7m². Sipërfaqe bruto e katit III është S=496.3m². Sipërfaqe neto e katit III është S=445.7m². Sipërfaqe bruto e katit teknik është S=176.2m². Sipërfaqe neto e katit teknik është S=149.7m². Sipërfaqe bruto e objektit është S=3589.3m². Sipërfaqe neto e objektit është S=3134.0m².	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **15,039.16 Euro.**
- Paralogaria e vlerës së objektit sipas këtij dokumentacioni teknik është në shumën prej **720,771.00 €.**

Lloji i ndërtimit të propozuar:		
Ndërtimi i ri ☒	Rindertim ☐	Riparim ☐
Kategoria e ndertimeve te propozuera:		
Kategoria I ☐	Kategoria II ☐	
A perfshin kerkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒		
Perdorimi i propozuar:objektit –afarist(administratë)		

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Sedat Asllani i lejohet ndërtimi i objektit – afarist-(administratë) me etazhitet 2B+P+3 .**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontratkuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuatë dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;

- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Sedat Asllani ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e lejes ndërtimore për **objektin –afarist (administratë).**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit,
- Pëlqimi nga “KEDS-i”,
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”,
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja,
- Pëlqimi nga Kompania Rajonale e Ujitjes –“Dugagjini”.
- Aktvendimi nga Drejtoria e Emergjencës dhe Sigurisë,
- Vendimi për Leje Mjedisore Komunale,
- Pëlqimi nga Drejtoria e Rrugëve nga MMPHI-ja,
- Vërtetimi nga sektori i menagjimit të mbeturinave,
- Tri kopje të projektit kryesor.

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.


DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-104569 dt.02.09.2024

Bashkëpunëtorë profesionale:


Egzona Morina-Thaqi ark.dipl.

DREJTORI


Pranverim Berisha jur.